



Pranuar / Dostiguar Prilipen / Pristato Received / Delivery	09-01-2024	9	viti god Year
Organ / Shkëmbim Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK/139/2024			117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1399/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Eshref Shabani dhe Jeton Koca, anëtarë; me Avdyl Bekteshi-Zyrtar : Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1399/2023. të datës 10.11.2023. të parashtruar nga ankuesit .

, të përfaqësuar nga ankuesi me autorizim të përvashkët, kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05 janar 2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1399/2023, e datës 10.11.2023, e parashtruar nga ankuesit

, ndërsa, çështja kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* të Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike.

II. Obligohet Komision për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj çështjen e përfshirjes së ankuesve në listën e eksperteve dhe te ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



A r s y e t i m

Ankuesit

, të cilët me autorizim të përbashkët i përfaqëson , (me tej referuar ankuesit), më datë 10.11.2023, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjë A.nr.1399/2023, kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, lidhur me aprovimin e listës së eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me pretendimet ankimore së përmes aktit të kontestuar u janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, pasi që janë trajtuar në mënyrë të pa te drejtë dhe jo të barabartë nga Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, ndërsa, ky i fundit, me datë 30.11.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6957/2023 të datës 10.11.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin AE.Nr.41/2022 i datës 13.12.2022 i ankuesit M.B; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës së Udhëheqësit të Divizionit të Operacioneve dhe përkrahjes; Akt Emërimin AE.Nr.74/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit A.Gj; Akt Emërimin AE.Nr.80/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit R.B; Akt Emërimin AE.Nr.76/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit F.G; Akt Emërimin AE.Nr.79/2022 i datës 27.12.2022 i ankueses M.J-K; Akt Emërimin AE.Nr.75/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit F.Q; Akt Emërimin AE.Nr.78/2022 i datës 27.12.2022 i ankueses L.LI-K; Akt Emërimin AE.Nr.73/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit A.K; Akt Emërimin AE.Nr.77/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit I.S; Akt Emërimin AE.Nr.83/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit S.M; Akt Emërimin AE.Nr.82/2022 i datës 27.12.2022 i ankuesit Sh.T; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës së pozitës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes; Vendimin me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Aneksi I- lista e titujve që do të jetë përftues të masave stimuluese; Vendimin me Nr. 01/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Organogramin e Administratës Tatimore të Kosovës; Pyetësor për identifikimin e sistemeve shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike; Kërkesën për miratimin e listës së Ekspertëve të kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik e datës 24.03.2023; Kërkesën për sqarim rreth mos përfshirjes së një pjesë të zyrtarëve e datës 24.10.2023 e dërguar nga Drejtori i Departamentit të TI-së; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.11.2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.11.2023; Vendimin me Nr. 23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raportin e punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike;

Emailin e datës 24.03.2023 nga I.M për Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Emailin e datës 13.03.2023 për anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Procesverbal i datës 05.04.2023 i Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi qw ka nxjerw aktin e kontestuar më ankesë , *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe atë: _____, në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes, _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes dhe _____ në pozitën e punës Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes.

Tutje nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.07/132 të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet që kanë të bëjnë me sistemin shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe listën e pozitave të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023.

Duke qenë së zyrtarët e Njesisë për operacione dhe përkrahje të Administratës Tatimore të Kosovës nuk janë të përfshirë nga Komisioni gjegjës në listën e eksperteve, sipas shtojcës 14.4 të ligjit për paga në sektorin publik, ankuesit parashetrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke kundërshtuar Raportin e Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, lidhur me aprovimin e listës së eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me pretendimet ankimore së përmes aktit të kontestuar u janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, pasi që janë trajtuar në mënyrë të pa te drejt dhe jo të barabartë nga Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, me rastin e mos përfshirjes së ankuesve në listën e eksperteve. Theksojnë se ky i fundit ka zbatuar gabimisht dispozita e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertet, për faktin se nuk janë marr për bazë përshkrimi i

detyrave të punës se ankuesve, pasi që Roli i Divizionit të Operacioneve dhe Përkrahjes është menaxhimi, administrimi dhe mirëmbajtja e të gjitha pajisjeve tjera harduerike, menaxhimi dhe administrimi i instalimeve dhe konfigurimeve të softuerëve dhe të gjitha aplikacioneve në përdorim qofshin ato të brendshme apo të jashtme, sigurinë e sistemeve me antivirus, përditësime dhe mbrojtje nga sulmet e brendshme dhe të jashtme kibernetike, përditësimeve të Sistemeve operative (WSUS), softuerëve, aplikacioneve dhe veglave tjera, menaxhimi, administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik dhe telefonisë fikse. Kërkojnë që këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyrohet Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike të bej ndryshimin dhe plotësimin e Raportit të Punës të miratuar me Vendimin e Qeverisë të datës 12.10.202, ashtu që ankuesin M. Breznica ta përfshij në pozitën ekspert 3 klasa B3, ndërsa ankuesit tjerë të përfshihen në Ekspert 6 Klasa B6 sipas Shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit duke vepruar sipas autorizimeve kushtetues dhe ligjore për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. me theks të veçantë:

- Nenin 3, më të cilin është përcaktuar se: 1. *Shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim: 1.1. sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike - nënkupton sistemet që plotësojnë së paku njërin nga kriteret në vijim: 1.1.1. infrastruktura kritike e informacionit (IKI), që përfshinë sistemet ose funksionet, paaftësimi ose shkatërrimi i të cilave do të mund të cenonte sigurinë kombëtare, qeverisjen, ekonominë ose mirëqenien sociale të vendit; 1.1.2. sistemet përmes të cilave qeveria realizon funksionet e saj themelore (sistemet e tatimeve, doganave, thesarit, buxhetit, prokurimit publik, shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit, sigurisë, gjykatave, prokurorisë, sigurisë kibernetike, mbrojtjes, etj); 1.1.3. regjistrat kyç shtetëror (regjistri civil, regjistrat kadastral, regjistri i bizneseve, regjistri i OJQ-ve, regjistri i lëndëve gjyqësore, regjistri i adresave, regjistri i automjeteve, etj.); 1.1.4. sistemet të cilat lidhen me menaxhimin e proceseve në administratën publike (sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemin për menaxhimin e financave, sistemi i postës elektronike zyrtare shtetërore, sistemi për menaxhimin e pasurisë shtetërore, etj.). 1.1.5. sistemet qendrore të Qeverisjes (Platforma e interoperabilitetit, Portali qendror për shërbime ndaj qytetarëve dhe bizneseve, Sistemi i identifikimit dhe nënshkrimit elektronik); 1.1.6. qendrat shtetërore të të dhënave; 1.1.7. rrjeti qeveritar; 1.1.8. sistemet e sigurisë që mundësojnë sigurinë kibernetike, sigurinë e rrjetit qeveritar, të dhënave dhe të qasjes në sisteme kompjuterike.*

- **Nenin 4:** *Institucioni i cili vlerëson se posedon, menaxhon ose koordinon funksionimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike e që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të bëjnë kërkesë tek Komisioni, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje. 2. Kërkesa e Institucionit për konsiderimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe*

komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore duhet të përmbajë: 2.1. informacionin për nivelin e klasifikimit të sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.2. kategorinë e shërbimeve që ofrojnë sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.3. përshkrimin e të dhënave që përmbajnë sistemet përkatëse; 2.4. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e objektivave të institucioneve shtetërore; 2.5. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e obligimeve ligjore të institucionet kërkuar dhe institucioneve tjera shtetërore; 2.6. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e shërbimeve esenciale siç janë: shërbimet publike, shëndetësia, siguria, drejtësia, arsimi dhe mbrojtja; 2.7. rrezikun për sisteme përkatëse të rrjetit dhe informacionit nga sulmet kibernetike të brendshme apo të jashtme; 2.8. funksionet menaxhuese/koordinuese dhe shkallën e njohurive të specializuara që kërkojnë për menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe avansimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.9. periudhën kohore të përcaktuar që sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit mund të mbeten jashtë funksionit; 2.10. sa është unik në nivel shtetëror secili sistemi përkatës i rrjetit dhe informacionit dhe a ofrohen shërbime të ngjashme edhe nga sisteme të tjera të rrjetit dhe informacionit nga institucione tjera shtetërore; 2.11. përshkrimin e informacioneve të tjera të rëndësishme për sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit që nuk janë përshkruar më lartë dhe që e bëjnë të nevojshme vlerësimin e këtyre sistemeve të rrjetit dhe informacionit si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore; 2.12. datën e futjes në funksion të sistemeve përkatëse të informacionit dhe komunikimit; 2.13. emërtimin e pozitave kyçe që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemet përkatëse të informacionit dhe komunikimit, dhe propozimin për kategorizim të tyre sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. 3. Kategorizimi i sistemeve në bazë të shërbimeve që ofron sipas paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të këtij neni ndahet si më poshtë: 3.1. shërbime për qytetarë 3.2. shërbimet për shëndetësi; 3.3. shërbime për financa / prokurim; 3.4. shërbime për siguri dhe mbrojtje; 3.5. shërbime për arsim; 3.6. shërbime për drejtësi; 3.7. shërbime interne për administratë publike. 4. Kërkesa e aprovuar nga Zyrtari më i lartë administrativ i institucionit, dërgohet tek komisioni qeveritar për vlerësim të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.

-Neni 5: Kriteret për caktimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike. Sistemet do të vlerësohen si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike nëse plotësojnë të paktën një prej kriterëve të përcaktuara në përkufizimin :e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në paragrafin 1.1 të nenit 3 të kësaj Rregulloreje....”

Neni 6:”... 5. Klasat e pozitive si në paragrafin 4 të këtij neni, ju dedikohen mbajtësve të pozitive drejtuese të njërive organizative të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke filluar nga drejtues të departamenteve, drejtorive, divizioneve, sektorëve apo njërive varësisht nga organizimi institucional në nivel të ndryshëm të Ministrive, Agjencive apo institucioneve të tjera të pavarura, koordinatorë qendrorë të procesit të digjitalizimit, deri në nivel të ekspertëve profesional që administrojnë, zhvillojnë ose mbështesin sisteme shtetërore me rëndësi strategjike. 6. Lista e ekspertëve sipas paragrafit 4 të këtij neni duhet të përmbajë minimalisht të dhënat si në vijim: 6.1. sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike; 6.2. institucionet që posedojnë, menaxhojnë e koordinojnë sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike; 6.3. llojet dhe klasat e pozitive të përcaktuara brenda secilit institucion që posedon, menaxhon ose koordinon sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.

Po ashtu për vendosje të drejtë lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji iu referua Rregullores (ZKM) Nr. 02/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, gjegjësisht nenit 4 lidhur me strukturën organizative në Administratën Tatimore të Kosovës e përbërë nga: 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv; 1.2. Departamentet; dhe 1.3. Divizionet, ndërsa neni 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, ka përcaktuar se: “1.7. Departamenti i Teknologjisë Informative: 1.7.1. Divizioni i Administrimit të Sistemit; 1.7.2. Divizioni i Mirëmbajtjes dhe Përkrahjes së Aplikacionit Bazë; 1.7.3. Divizioni i Zhvillimit të Aplikacioneve; 1.7.4. Divizioni i Operacioneve dhe Përkrahjes”, ndërsa neni 34 i kësaj rregullore ka përcaktuar: “2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Operacioneve dhe Përkrahjes janë: 2.1. Ofron përkrahjen e shfrytëzuesëve në përdorimin e shërbimeve dhe pajisjeve të TI-së në kuadër të ATK-së; 2.2. Përkrah përdoruesit në shfrytëzimin e sistemeve të jashtme të institucioneve tjera për nevoja të ATK-së; 2.3. Sigurohet se të gjithë përdoruesit marrin përkrahjen e adekuate qoftë nga niveli i parë i përkrahjes qoftë nga nivelet tjera përmes delegimit të kërkesave. 3. Divizioni i Operacioneve dhe Përkrahjes udhëhiqet nga Udhëheqësi dhe i raporton Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë Informative”.

Madje, Kolegji i Këshillit, ka analizuar përshkrimin e detyrave të punës së ankuesve si dhe Pyetësozin e përcjell nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore përmes shkresës së datës 24.10.2023, drejtuar Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, nga dhe ka konstatuar se roli i Divizionit të Përkrahjes janë: *te përkrah shfrytëzuesit e sistemeve të IT-së duke siguruar që të gjithë të marrin shërbimet përkatëse. Përkraha shfrytëzuesit rreth përdorimit të të gjitha pajisjeve të IT-së si dhe të sigurohet për funksionim të mirëfillti, përditësimet adekuate në sistem, Menaxhimi, Administrimi i pasjeve dhe komponentëve harduerike (instalime, konfigurime, mirëmbajtje) për të gjithë përdoruesit e ATK-së; Menaxhimi, Administrimi të softuerëve (instalime, konfigurime, mirëmbajtje) të punës për të gjithë përdoruesit në ATK, duke përfshirë aplikacionet e brendshme dhe ato të jashtme; Menaxhimi, Instalime, administrim dhe përkrahje të Antivirusit dhe Përditësimeve të Microsoft (Konzolla e SOPHOS dhe WSUS-it) dhe Menaxhimi, Instalimi, mirëmbajtje e rrjetit kompjuterik dhe atë të telefonisë fikse në nivel të Drejtorive Rajonale.*

Rtjedhimisht, nga vlerësimi i Raportit të Punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, rezulton se Komisioni në fjalë ka kategorizuar si sisteme me rëndësi strategjike në Administratën Tatimore të Kosovës këto sisteme të TIK: 1. SIGTAS; 2. Oracle Audit Vault and Data Base Firewall; 3. Sistemi për Menaxhim e PEF-ve/SMPF-Portali t/p SMPEF; 4. Portali i jashtëm EDI; 5. Portali i Brendshëm, sistemi raportues (Intraneti në SharePoint); 6. FATCA; 7. Infrastruktura e rrjetave të komunikimit dhe sigurisë; 8. Ueb faqja e ATK-së Denoncimi i punëdhënësit, Vërtetimi Tatimor; 9. Sistemet për Regjistrimin e aktiviteteve (Vizitat, Kontrollat, Mbledhje, Edukim) të Zyrtarëve të ATK-së; 10. Sistemet për Menaxhimin e Certifikatës së TVSH-së për Menaxhimin e Pasivizimit të Tatimpaguesve për Menaxhimin Çregjistrimit të tatimpaguesve; 9. Interoperabiliteti; dhe 11. **Infrastrukturë/Sistem Tatimor/Administrim dhe Përkrahje.** Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve Kolegji konstaton se Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, me rastin e mos përfshirjes së ankuesve në listën e eksperteve nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka vepruar në kundërshtim me vet konstatimet e tij si në raportin e punës, për faktin se Komisioni përveç sistemeve tjerë të TIK-ut që menaxhohen dhe administrohen nga ATK-ja, ka kualifikuar si sistem strategjik të rëndësisë shtetërore edhe sistemin e

Infrastrukturës/Sistem Tatimor/Administrimit dhe Përkrahjes, sistem ku që administrohet dhe mbështet nga ankuesit në pozitat Udhëheqës i Divizionit të Operacioneve dhe Përkrahjes Administrator i Operacioneve dhe Përkrahjes dhe Zyrtar i TI-së për Përkrahje. Kështu që komisioni gjegjes ka vepruar edhe në kundërshtim me shtojcën N.14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertët, sepse vet kualifikimi i sistemit të TIK si sistem shtetërore me rëndësi strategjike, nënkupton edhe kualifikimin e mbajtëse të pozitave të IT-së siç është përcaktuar me shtojcën nr.14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

Për sa me sipër, e si rezultat i shkeljeve të evidentuara si me lartë, u vendos që të aprovohet ankesa si e bazuar, dhe çështja të kthehet në *rishqyrtim* të Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, me detyrimin që ky i fundit në ri-procedurë të veproj sipas pikëpamjeve juridike të këtij vendimi, duke rishqyrtuar çështjen e përfshirjes së ankuesve në listën e eksperteve dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, theksuar si me lart Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1399/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Artita HAXHNIKA I DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit përfaqësuesi i përbashkët i ankuesve;
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike/Qeveria e Kosovës;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.